

Maj 2025

Nr . (1)	Data e regjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Përgjigja(5)	Statusi i kërkesës (6)	Tarifa (7)
27	05.05.2025	Kërkesë për informacion ne lidhje me: 1. A ka paraqitur ministri kërkesë për leje vjetore apo pezullim nga detyra gjatë periudhës 11 prill – 10 maj 2025? Ju lutem të përcillni kopje të urdhrit apo shkresës përkatëse nëse ekziston. 2. Ju lutem të dërgoni listën e urdhrave të shërbimit dhe dietave të miratuara për ministrin, shoferin dhe anëtarët e kabinetit të tij gjatë periudhës 11 prill – 10 maj 2025, për çdo dalje apo aktivitet të zhvilluar në zonën zgjedhore ku ai/ajo kandidon. 3. A është tërhequr paga për muajin prill 2025 nga ministri? Nëse po, në çfarë date është kryer pagesa?	20.05.2025	Ju informojmë se për periudhën nga data 11 prill 2025 deri më 11 maj 2025, Ministrja e Turizmit dhe Mjedisit Mirela Kumbaro ka deleguar kompetencat nëpërmjet urdhrit nr.141, datë 11.04.2025. Ndërsa angazhimi elektoral i saj është zhvilluar në përputhje me funksionin kushtetues të Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sipas kuadrit ligjor në fuqi. Gjithashtu, ju informojmë se nuk ka asnjë urdhër shërbimi/shpenzimi për Ministren apo Kabinetin e Ministrin për periudhën e sipërcituar në zonën elektorale të Qarkut të Gjirokastrës.	Përfunduar	0

28	13.05.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me: 1. Vendimin e plotë të revokimit të lejes mjedisore të kompanisë “*****”.	13.05.2025	Deleguar te Agjencia Kombëtare e Mjedisit	Përfunduar	0
29	23.05.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me: A ka qenë Ministria në dijeni të problemeve të ndotjes nga **** përpara vendimit të ISHM-së për pezullimin e aktivitetit? · A ka pasur raportime lidhur me problemet e ndotjes nga *****? · A është **** pajisur me leje mjedisore aktive nga Ministria/Agjencitë vartëse? · A ka pasur ndonjë kontroll apo auditim mjedisor nga vetë Ministria apo në bashkëpunim me AKM ndaj kësaj kompanie përpara vitit 2025?	24.05.2025	Deleguar te Agjencia Kombëtare e Mjedisit	Përfunduar	0
30	28.05.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me: A ka institucioni strategji për zhvillimin e turizmit të kroçerave në vendin tonë? Nëse po çfarë synon zbatimi i saj, cilat janë prioritet dhe si ka ecur zbatimi? Nëse jo, a ka institucioni në projekt hartimin e një strategjie të		Në proces		

		tillë dhe çfarë do të synojë ajo? 2. Sa është numri i kroçerave të mbërritura në portet e vendit tonë në pesë vitet e fundit? Specifikoni sipas viteve. 3. Sa është numri i turistëve të mbërritur në vendin tonë me kroçera, specifikoni sipas viteve. 4. Nga cilat shtete vijnë kryesishtë kroçerat që mbërrijnë në vendin tonë?				
31	29.05.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me: ose dokumente për Parkun Natyror “Porto Palermo”. 1. Në faqen e internetit të AKZM-së shkruhet se “Zona e mbrojtur Gjiri Porto Palermos - Llamani gjendet tërësisht brenda territorit administrativ të Bashkisë Himarë ...”. Ndërkohë, Gjiri i Llamani si dhe kodra sipër këtij plazhi është jashtë zonave të mbrojtura, teksa këto vendime i kanë hapur rrugë ndërtimit në atë zonë; a) Në gusht të vitit 2015, u bë një studim “Plani i Menaxhimit për Parkun Natyror ‘GJIRI I PORTO PALERMOS – LLAMANI’”. Sipërfaqja që duhej mbrojtur sipas	30.05.2025	Kthyer përgjigje nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura	Përfunduar	0

		këtij studimi ishte 2,067.75 ha. Studimi kaloi në Ministrinë e Mjedisit dhe më pas në qeveri, teksa çuditërisht sipërfaqja u rrudh në vetëm 1,694.98 ha. U miratua një VKM me emërtimin “Park Kombëtar”, teksa nuk bën më fjalë për Llananin, por vetëm për Porto Palermon. b) Pas këtij vendimi, KKTU ka marrë një vendim me numër 13, datë 25.09.2024 për “Miratimin e lejes së Zhvillimit për objektin ‘Resort Multifunksional, Hotel, Vila dhe Shërbime ‘Amantes’, me vendndodhje në Bashkinë Himarë”. Propozimi është bërë nga subjektet zhvilluese “****” shpk dhe “*****” shpk. Vendimi ka edhe emrin, firmën dhe vulën e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit znj. Mirela Kumbaro. 2. Emisioni Fiks Fare kërkon intervistë me ministren e Turizmit dhe Mjedisit, ose një funksionar të lartë të kësaj ministrie, për të gjitha procedurat për Gjirin e Llananit, lënia jashtë nga Zona e				
--	--	---	--	--	--	--

		Mbrojtur apo edhe lejimin e ndërtimeve të shumta në atë zonë. 3. Kërkojmë dokumentet e praktikave të mbajtura, si për shpalljen e Parkut Natyror “Porto Palermo” gjithashtu edhe për praktikat e mbajtura mes Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe KKTU-së për lejen e zhvillimit të datës 25.09.2024. 4. Në gjithë këto praktika, a është pyetur pushteti lokal, Bashkia e Himarës?				
--	--	--	--	--	--	--

Shënim:

Regjistri përditësohet çdo muaj.

- (1) Evidentohet kronologjia e kërkesave.
- (2) Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesës.
- (3) Identifikohet lloji i kërkesës.

(4) Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës dhe **nëpërmjet klikimit njohja me përmbledhjen e përgjigjes.**

(Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”)

(5) **Ndihmon kërkuesin për të njohur ecurinë e procesit.**

(6) **Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.**